



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

www.qpz.gov.al

Nr.114

22 korrik

2008

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9942 datë 26.6.2008	Për parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizmin e njeriut.....	5007
Ligj nr.9943 datë 26.6.2008	Për disa ndryshime në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi ardhurat”, të ndryshuar	5012
Ligj nr.9944 datë 26.6.2008	Për një ndryshim në ligjin nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar	5014
Ligj nr.9945 datë 26.6.2008	Për një shtesë dhe ndryshim në ligjin nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”, të ndryshuar	5015
Ligj nr.9946 datë 30.6.2008	Për sektorin e gazit natyror	5015

LIGJ
Nr.9942, datë 26.6.2008

**PËR PARANDALIMIN E ÇRREGULLIMEVE TË SHKAKTUARA NGA
PAMJAFTUESHMËRIA E JODIT NË ORGANIZMIN E NJERIUT**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i ligjit

Ky ligj ka për qëllim parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizmin e njeriut, nëpërmjet jodizimit të përgjithshëm të kripës, të destinuar për konsum njerëzor e shtazor dhe për përdorim në industrinë ushqimore.

Neni 2
Fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet për të gjitha subjektet prodhuese, importuese, eksportuese dhe tregtuese të kripës, të destinuar për konsum njerëzor e shtazor dhe për përdorim në industrinë ushqimore në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Çrregullime nga pamjaftueshmëria jodike” është një spektër i gjerë çrregullimesh, të dukshme apo të fshehura, të cilat shkaktohen si rezultat i pamjaftueshmërisë së sasisë së jodit në trup, që ndikojnë në zhvillimin intelektual dhe fizik të njeriut. Ato mund të shkaktojnë prapambetje mendore, defekte fizike, strumë etj.
2. “Parandalimi i çrregullimeve me shkak pamjaftueshmërinë jodike” është një sistem masash të marra për përmbushjen e nevojës fiziologjike të organizmit për jod.
3. “Jodizimi i përgjithshëm i kripës” është procesi i pasurimit/shtimit të jodit në kripën për përdorim njerëzor e shtazor dhe në industrinë ushqimore.
4. “Kripë ushqimore e jodizuar” është kripa, së cilës i është shtuar jod, e destinuar për konsum njerëzor e shtazor dhe për përdorim në industrinë ushqimore.
5. “Kripë industriale” është kripa, e cila nuk përdoret për qëllimet e përcaktuara në këtë ligj.
6. “Fortifikimi i kripës me jod” është procesi i shtimit të një sasive jodi në kripë për plotësimin e nevojave fiziologjike të organizmit të njeriut dhe të kafshëve me jod.
7. “Konsum direkt” është marrja e jodit, nëpërmjet kripës me jod, nga njerëzit dhe kafshët.
8. “Konsum indirekt” është marrja e jodit nga produktet dhe nënproduktet ushqimore të industrializuara, të cilat janë përpunuar, paraprakisht, me kripë të jodizuar, si dhe nga produktet blegtorale.

KREU II KRITERET PËR CILËSINË DHE SIGURINË

Neni 4

Detyrimi për jodizimin e kripës

Jodizimi i përgjithshëm i kripës për konsum njerëzor e shtazor dhe për përdorim në industrinë ushqimore është i detyrueshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 5

Niveli i jodizimit për kripën e prodhuar në vend

Kripa, e prodhuar në vend për konsum të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë, njerëzor e shtazor dhe për përdorim në industrinë ushqimore, nuk lejohet të jodizohet në një nivel më të ulët se 40 mg jod për kg kripë dhe më të lartë se 60 mg jod për kg kripë në pikën e prodhimit.

Neni 6

Niveli i jodizimit për kripën e importuar

Kripa, që importohet në territorin e Republikës së Shqipërisë për konsum njerëzor e shtazor dhe për përdorim në industrinë ushqimore, në çastin e mbërritjes duhet të jetë e jodizuar në një nivel jo më të ulët se 40 mg jod për kg kripë dhe jo më të lartë se 60 mg jod për kg kripë.

Neni 7

Niveli minimal i jodizimit për kripën që hidhet në treg

Niveli i jodit në kripën, që tregtohet në territorin e Republikës së Shqipërisë për konsum njerëzor e shtazor dhe për përdorim në industrinë ushqimore, nuk lejohet të jetë më i ulët se 20 mg jod për kg kripë.

Neni 8

Fortifikimi i kripës me jod

1. Niveli i jodit në kripën e jodizuar shprehet vetëm si përmbajtje e jodit në të.
2. Komiteti Kombëtar për Eliminimin e Pamjaftueshmërisë Jodike është i vetmi organ këshillimor, i cili propozon ndryshimet në sasinë e nivelit të jodit në kripën e jodizuar, sipas neneve 5, 6 e 7 të këtij ligji, në përputhje me situatën në vend dhe me rekomandimet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH), Fondit të Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF) dhe Këshillit Ndërkombëtar për Kontrollin e Çrregullimeve të Pamjaftueshmërisë Jodike (ICCIDD).

Neni 9

Ndalimi i përdorimit të kripës së pajodizuar

Në territorin e Republikës së Shqipërisë ndalohen prodhimi, importimi, tregtimi dhe marketingu i kripës së pajodizuar për konsum njerëzor e shtazor dhe për përdorim në industrinë ushqimore.

Neni 10

Kriteret për hedhjen në treg të kripës së jodizuar

Asnjë person fizik ose juridik nuk duhet të prodhojë, të importojë, të tregtojë, të shpërndajë, të magazinojë kripë të jodizuar për konsum njerëzor, shtazor dhe për përdorim në industrinë ushqimore, kur:

- a) ka arritur data e skadimit;
- b) ka arritur data e skadimit, sipas llojit të fortifikimit:
 - i) 6 muaj nga data e prodhimit për jodurin;
 - ii) 12 muaj nga data e prodhimit për jodatin;
- c) nuk është në përputhje me treguesit cilësorë, të përcaktuar në këtë ligj dhe me standardet e miratuara në Republikën e Shqipërisë.

Neni 11

Ambalazhimi dhe etiketimi

1. Ambalazhimi, etiketimi, transportimi dhe ruajtja e kripës së jodizuar bëhen në përputhje me legjislacionin dhe me standardet në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
2. Etiketa e përdorur për kripën e jodizuar, krahas të dhënave të përcaktuara në legjislacionin për ushqimin, duhet të përmbajë edhe datën e skadencës, sipas llojit të fortifikimit, në përputhje me shkronjën “b” të nenit 10 të këtij ligji. Emërtimi i produktit të jetë “Kripë e jodizuar”.
3. Në etiketën e kripës së jodizuar mund të vendosen mesazhe promovionale, të cilat nxisin përdorimin e saj nga popullata.

KREU III

KONTROLI DHE MONITORIMI I KRIPËS SË JODIZUAR

Neni 12

Kontrolli i kripës së jodizuar

1. Kripa e jodizuar, e prodhuar ose e importuar, e destinuar të tregtohet në Republikën e Shqipërisë, është objekt kontrolli i Inspektoratit Sanitar Shtetëror dhe i institucioneve të përcaktuara shëndetësore.
2. Ministri i Shëndetësisë përcakton institucionet shëndetësore, që do të kryejnë analizat, për përcaktimin e nivelit të jodit në kripën e jodizuar.
3. Kontrolli i kripës së jodizuar bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi, nëpërmjet analizave laboratorike për përcaktimin e nivelit të jodit në mostrën e kripës së jodizuar, sipas rekomandimeve të OBSH-së, ICCIDD-it dhe UNICEF-it.
4. Për kripën e jodizuar të importit, edhe në rastet kur në dokumentet shoqëruese është pasqyruar niveli i jodit, importuesi është i detyruar të kryejë analizën laboratorike për nivelin e jodit, sipas pikës 3 të këtij neni, në çastin e futjes së kripës në pikën doganore.

Neni 13

Monitorimi i kripës së jodizuar

1. Monitorimi i nivelit të jodit në kripë, në pikat e prodhimit në vend apo në ato të importimit dhe në pikat e shitjes me pakicë/shumicë, kryhet nga Inspektorati Sanitar Shtetëror, në përputhje me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e këtij institucioni.
2. Prodhuesi i kripës së jodizuar në vend dhe importuesi i saj janë përgjegjës për cilësinë e kripës së jodizuar.
3. Në rastet kur kripa e jodizuar importohet, verifikimi dhe vlerësimi i dokumenteve shoqëruese të saj në pikat e kalimit kufitar janë të detyrueshëm dhe kryhen nga përfaqësuesit e Inspektoratit Sanitar Shtetëror dhe ata të doganës, brenda kompetencave përkatëse.

KREU IV
KOMITETI KOMBËTAR PËR ELIMINIMIN E ÇRREGULLIMEVE
NGA PAMJAFTUESHMËRIA JODIKE

Neni 14

Komiteti Kombëtar për Eliminimin e Çrregullimeve
nga Pamjaftueshmëria Jodike (KKEÇPJ)

1. Pranë Ministrinë së Shëndetësisë funksionon Komiteti Kombëtar për Eliminimin e Çrregullimeve nga Pamjaftueshmëria Jodike (KKEÇPJ) si organ këshillimor.
2. Përbërja, organizimi dhe funksionimi i këtij komiteti përcaktohen nga Ministri i Shëndetësisë.

Neni 15

Kompetencat e KKEÇPJ-së

KKEÇPJ-ja ka këto kompetenca:

- a) orienton politikat dhe strategjitë për mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga çrregullimet, që shkaktohen nga pamjaftueshmëria jodike;
- b) i propozon Ministrin të Shëndetësisë rishikimin e akteve ligjore dhe nënligjore për mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga pamjaftueshmëria jodike;
- c) propozon ndryshimet në sasinë e nivelit të jodit në kripën e jodizuar, sipas situatës së pamjaftueshmërisë jodike në vend;
- ç) propozon programe dhe projektakte, sipas shkronjës “a” të këtij neni dhe bën monitorimin e vlerësimit të tyre;
- d) siguron bashkëpunimin me institucione të ndryshme, të interesuara, brenda dhe jashtë vendit, sipas qëllimit të këtij ligji.

Neni 16

Promovimi i konsumit të kripës së jodizuar

Autoritetet shëndetësore, kombëtare dhe vendore, duhet të promovojnë dhe të mbështesin, në kuptim të këtij ligji, konsumin e kripës së jodizuar dhe të informojnë popullatën për çrregullimet që shkaktohen nga pamjaftueshmëria jodike.

KREU V

KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 17

Kundërvajtjet administrative

Kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative shkeljet e mëposhtme:

1. Importimi, prodhimi, shpërndarja, tregtimi apo marketingu i kripës së pajodizuar ose me nivel jodi më të ulët se ai i përcaktuar në këtë ligj, për konsum njerëzor e shtazor.
2. Përdorimi i kripës së pajodizuar ose i kripës së jodizuar, me një nivel më të ulët se ai i përcaktuar në këtë ligj, në industrinë ushqimore.
3. Importimi, shpërndarja, tregtimi apo reklamimi i kripës së jodizuar për konsum njerëzor e shtazor dhe për përdorim në industrinë ushqimore pas datës së skadencës, sipas llojit të fortifikimit.
4. Mospërputhja me treguesit e cilësisë, të ambalazhimit, etiketimit, transportit dhe ruajtjes.

Neni 18
Sanksionet

1. Kundërvajtjet administrative, të parashikuara në nenin 17 të këtij ligji, dënohen me gjobë si më poshtë:

a) 500 mijë lekë, shoqëruar me bllokim, kthim mbrapsht të mallit, në përputhje me ligjin, sipas rastit, për prodhuesin, tregtuesin apo importuesin e produktit, për shkeljen e parashikuar në pikën 1 të nenit 17 të këtij ligji;

b) 500 mijë lekë, shoqëruar me bllokimin e mallit, për shkeljen e parashikuar në pikën 2 të nenit 17 të këtij ligji;

c) 200 mijë lekë, shoqëruar me bllokimin e mallit, për shkeljen e parashikuar në pikën 3 të nenit 17 të këtij ligji;

ç) për shkeljet e parashikuara në pikën 4 të nenit 17 të këtij ligji:

i) 500 mijë lekë, shoqëruar me bllokimin e mallit, kur kemi mospërputhje me treguesit cilësorë;

ii) 200 mijë lekë, shoqëruar me bllokim dhe riambalazhim të mallit, në përputhje me ligjin, kur shkeljet lidhen me ambalazhimin, etiketimin, transportin dhe ruajtjen.

2. Autoriteti përgjegjës për vënien dhe ekzekutimin e gjobave është Inspektorati Sanitar Shtetëror.

Neni 19
Pezullimi dhe heqja e licencës

1. Inspektorati Sanitar Shtetëror, për shkelje të përsëritur të pikave 1, 2 dhe 3 të nenit 17 të këtij ligji, u propozon institucioneve përkatëse heqjen e licencës për subjektin përgjegjës.

2. Inspektorati Sanitar Shtetëror, për shkelje të përsëritur të pikës 4 të nenit 17 të këtij ligji, u propozon institucioneve përkatëse pezullimin e përkohshëm ose të përhershëm të veprimtarisë së subjektit prodhues.

3. Ndryshimi i destinacionit të mallit, jo në përputhje me standardin për përdorim si kripë industriale, lejohet kundrejt dhënies së lejes përkatëse nga Ministria e Shëndetësisë.

Neni 20
Ankimimi

Kundër vendimit të dënimit me gjobë bëhet ankimim, në përputhje me procedurat e parashikuara në ligjin nr.7697, datë 7.4.1993 “Për kundërvajtjet administrative”, të ndryshuar.

Neni 21
Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Ministri i Shëndetësisë që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore, në zbatim të pikës 2 të nenit 12 të këtij ligji.

2. Ngarkohen Ministri i Shëndetësisë dhe Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrin rregulloren e përbashkët, në zbatim të pikave 1 e 2 të nenit 11 të këtij ligji.

3. Ngarkohen Ministri i Shëndetësisë dhe Ministri i Financave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrin udhëzimin e përbashkët, në zbatim të pikës 3 të nenit 13 të këtij ligji.

Neni 22
Shfuqizime

Vendimi nr.549, datë 27.11.1997 i Këshillit të Ministrave “Për importimin e kripës së

gjellës së jodizuar dhe prodhimin e saj në vend”, shfuqizohet.

Neni 23
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5805, datë 10.7.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ
Nr.9943, datë 26.6.2008

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8438, DATË 28.12.1998
“PËR TATIMIN MBI ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Neni 14 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 14
Kundërvajtjet administrative

Shkeljet e dispozitave për tatimin mbi të ardhurat personale, që përbëjnë kundërvajtje administrative, përcaktohen në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë””.

Neni 2

Neni 15 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 15
Sanksionet

Dënimet administrative për kundërvajtjet për tatimin mbi të ardhurat personale përcaktohen në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë””.

Neni 3

Neni 31 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 31
Kundërvajtjet administrative

Shkeljet e dispozitave për tatimin mbi fitimin, që përbëjnë kundërvajtje administrative, përveç mbajtjes së gabuar të llogarive pa pasoja në rezultatin financiar 1, përcaktohen në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 4

Neni 32 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 32
Sanksionet

1. Dënimet administrative për kundërvajtjet për tatimin mbi fitimin përcaktohen në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

2. Për rastet e shkeljeve, për mbajtje të gabuar të llogarive pa pasoja në rezultatin financiar 1, personat përgjegjës dënohen me gjobë 10 mijë lekë.”.

Neni 5
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5806, datë 10.7.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

**LIGJ
Nr.9944, datë 26.6.2008**

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7928, DATË 27.4.1995
“PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, neni 57 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 57
Kundërvajtjet administrative dhe sanksionet

Shkeljet e dispozitave për tatimin mbi vlerën e shtuar, që përbëjnë kundërvajtje

administrative dhe dënimet përkatëse përcaktohen në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5807, datë 10.7.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

**LIGJ
Nr.9944, datë 26.6.2008**

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7928, DATË 27.4.1995 “PËR TATIMIN MBI
VLERËN E SHTUAR”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, neni 57 ndryshohet si më poshtë:

**“Neni 57
Kundërvajtjet administrative dhe sanksionet**

Shkeljet e dispozitave për tatimin mbi vlerën e shtuar, që përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënimet përkatëse përcaktohen në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5808, datë 10.7.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ
Nr.9945, datë 26.6.2008

**PËR NJË SHITESË DHE NDRYSHIM NË LIGJIN NR.8976,
DATË 12.12.2002 “PËR AKCIZAT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”, të ndryshuar, në nenin 19 “Përjashtimet” bëhen shtesa dhe ndryshimi si më poshtë:

1. Në pikën 1, pas shkronjës “d” shtohet shkronja “e” me këtë përmbajtje:
“e) gazoili është shitur për anijet e peshkimit në sasi të, kushtet dhe kriteret e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.”.
2. Në pikën 2, shkronja “c” shfuqizohet.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5808, datë 10.7.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ
Nr. 9946, datë 30.6.2008

PËR SEKTORIN E GAZIT NATYROR

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi dhe objekti

1. Qëllimi i këtij ligji është krijimi i kuadrit ligjor për zhvillimin dhe rregullimin e sektorit të gazit natyror në Republikën e Shqipërisë, për të mundësuar një treg konkurrues dhe të integruar me tregjet rajonale dhe europiane, për një shërbim me cilësi të lartë dhe me kosto të arsyeshme.

2. Ky ligj përcakton politikat, rregullat e procedurat për organizimin dhe funksionimin e tregut të gazit natyror dhe veprimtaritë e lidhura me të, përfshirë procedurat, të drejtat e personave fizikë dhe juridikë për këto veprimtari.

Neni 2

Fusha e zbatimit

1. Ky ligj zbatohet për të gjitha veprimtaritë e sektorit të gazit natyror, përfshirë transmetimin, shpërndarjen, tregtimin, depozitimin, furnizimin, konsumin, si dhe ndërtimin dhe operimin e infrastrukturës së gazit natyror.

2. Veprimtaria e kërkimit dhe e prodhimit të gazit natyror nuk është objekt i këtij ligji. Ajo rregullohet nga ligji nr.7746, datë 28.7.1993 “Për hidrokarburet (Kërkim dhe prodhim)”, të ndryshuar.

3. Sektori i gazit natyror përfshin gazin natyror, gazin natyror të lëngëzuar (GNL), biogazin, si dhe gazin nga biomasa ose tipa të tjerë gazrash të tilla që, nga pikëpamja teknike dhe e sigurisë teknike, mund të injektohen e të transportohen nëpërmjet sistemit të gazit natyror.

Neni 3

Përkufizimet

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. Depozitim” është injektimi i gazit natyror në hapësirat depozituese, depozitimi dhe tërheqja e tij nga këto hapësira.

2. “E” është Enti Rregullator i Energjisë, përgjegjës për rregullimin e sektorit të energjisë elektrike dhe të gazit natyror, i cili organizohet dhe funksionon sipas dispozitave të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar dhe të këtij ligji.

3. “Forcë madhore” është një ngjarje ose një akt natyror apo shoqëror, që ndodh në vend, si tërmetet, ciklonet, rrufetë, përmytjet, shpërthimet vullkanike, zjarret, lufta, konfliktet e armatosura, kryengritjet, aktet terroriste, të cilat e pengojnë të licencuarin të përmbushë detyrimet sipas licencës, si dhe akte ose ngjarje të tjera, të cilat janë jashtë kontrollit të mundshëm të të licencuarit e nuk ndodhin për faj të tij dhe i licencuari nuk është në gjendje t’i eliminojë ato, edhe pse ka ushtruar aftësitë, përpjekjet dhe kujdesin e tij.

4. “Furnizim” është shitja e gazit natyror, përfshirë GNL-në, te klientët fundorë.

5. “Gaz natyror” është gazi metan, përfshirë gazin shoqëruar, si dhe të gjitha hidrokarburet, që janë në gjendje të gaztë, në kushte atmosferike normale, i cili, në kuptim të këtij ligji, përfshin edhe GNL-në, biogazin ose lloje të tjera gazi, që transmetohen dhe shpërndahen në sistemin e tubacioneve.

6. “Hapësirë depozitimi” është hapësira e përdorur për depozitimin e gazit natyror, që zotërohet dhe/ose operohet nga një shoqëri e gazit natyror, përfshirë pjesën e impianteve të GNL-së, të përdorura për depozitim, duke përjashtuar ato që përdoren për veprimtarinë e prodhimit, si dhe hapësirat e rezervuara ekskluzivisht për Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST) në kryerjen e funksioneve të tij.

7. “Hidrokarbur” është nafta bruto ose gazi natyror.

8. “Hyrje e palëve të treta” është e drejta e një pale të tretë për të hyrë dhe përdorur sistemin e gazit, me terma e kushte të përcaktuara.

9. “Hyrje në hapësirat e depozitimit” është e drejta e një prodhuesi, furnizuesi, transportuesi, klienti të kualifikuar apo e një personi të përdorë hapësirat e depozitimit në territorin e Republikës së Shqipërisë.

10. “Hyrje në sistemin e transmetimit/shpërndarjes” është e drejta dhe mundësia e një prodhuesi, furnizuesi dhe/ose klienti të kualifikuar të përdorë sistemin e transmetimit/shpërndarjes.

11. “Impiant GNL-je” është terminali, që përdoret për lëngëzimin e gazit natyror ose importin, eksportin, shkarkimin apo rigazifikimin e GNL-së, përfshirë shërbimet ndihmëse dhe depozitat e përkohshme, të nevojshme për procesin e rigazifikimit dhe livrimin e mëtejshëm në sistemin e transmetimit. Këtu nuk përfshihet asnjë pjesë e terminaleve të GNL-së, që përdoren për depozitim.

12. “Infrastrukturë e re” është infrastruktura, që nuk ka përfunduar deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji.

13. “IQT” është Inspektorati Qendror Teknik, që është krijuar dhe funksionon sipas dispozitave të ligjit nr.9595, datë 27.7.2006 “Për Inspektoratin Qendror Teknik”.

14. “Kapaciteti i disponueshëm” është kapaciteti i transmetimit, i shpërndarjes, i impiantit të GNL-së ose hapësirave të depozitimit, të përcaktuara sipas rregulloreve përkatëse, i cili mund t’u sigurohet përdoruesve të sistemit ose rrjetit nga operatori i sistemit.

15. “Klient” është subjekti, që blen me shumicë, si dhe klienti fundor i gazit natyror.

16. “Klient fundor” është klienti, që e blen gazin natyror për nevojat e veta.

17. “Klient i kualifikuar” është klienti, i lirë të blejë gaz nga furnizuesit, sipas zgjedhjes së vet.

18. “Klient me të ardhura të pakëta” është klienti, i cili, me të ardhurat që siguron, nuk është në gjendje të përballojë çmimin e gazit natyror dhe që përfiton nga programet mbështetëse të qeverisë.

19. “Klient rezidencial” është klienti, që blen gaz për konsum familjar dhe jo për veprimtari tregtare ose profesionale.

20. “Klient jorezidencial” është klienti, i cili blen gaz natyror, që nuk është për përdorim rezidencial.

21. “Klient tarifor” është klienti, i cili nuk është i lirë të blejë gaz nga furnizuesi i zgjedhur prej tij.

22. “Kontratë *take-or-pay*” është kontratë blerjeje ose shitjeje gazi, sipas së cilës blerësi e paguan sasinë e kontraktuar të gazit, pavarësisht nëse kjo sasi është konsumuar ose jo nga ai.

23. “Leje” është akti i miratimit nga organi i parashikuar në këtë ligj, për të ndërtuar dhe përdorur infrastrukturën e sistemit të gazit (tubacione gazsjellësish, impiante GNL-je apo hapësira depozituese), sipas procedurave përkatëse.

24. “Leje koncesioni” është leja e dhënë nga Këshilli i Ministrave për ndërtimin dhe përdorimin e një gazsjellësi, sipas dispozitave të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar.

25. “Lëngëzim i gazit natyror” është procesi i ftohjes së gazit natyror në kushte normale, deri në temperaturën -163oC, derisa ai të shndërrohet në gaz natyror të lëngëzuar (GNL).

26. “Licencë” është autorizimi, që i jepet një personi, sipas përcaktimeve të seksionit II të kreut III të këtij ligji, për t’u angazhuar në njërin nga veprimtaritë e sektorit të gazit natyror.

27. “*Linepack*” është një sasi gazi natyror, e ruajtur në gjendje të ngjeshur në sistemet e transmetimit dhe të shpërndarjes së gazit natyror, pa përfshirë kapacitetet teknologjike, të përdorura ekskluzivisht nga OST-ja.

28. “Linjë direkte” është një tubacion i gazit natyror, komplementar i sistemit të ndërlidhur, që lidh një burim të gazit me një klient.

29. “Linjë interkonjeksioni” është një linjë transmetimi, e cila kalon një kufi, ndërmjet dy vendeve, vetëm për të lidhur sistemet e transmetimit të këtyre vendeve.

30. “Ministër” është ministri përgjegjës për sektorin e energjisë.

31. “Ministria” është ministria përgjegjëse për sektorin e energjisë.

32. “Operim” është vënia në veprim dhe shfrytëzimi, në kuptimin tregtar, të infrastrukturës së sistemit të gazit natyror (tubacione gazsjellësish, impiante GNL-je apo hapësira depozitimi të gazit natyror).

33. “Operator i sistemit të depozitimit” është subjekti, i cili kryen veprimtarinë e depozitimit dhe është përgjegjës për operimin e hapësirave të depozitimit.

34. “Operator i sistemit të GNL-së” është subjekti, i cili kryen veprimtarinë e lëngëzimit të gazit natyror ose importin, eksportin, shkarkimin e rigazifikimit të GNL-së dhe është përgjegjës për operimin e impiantit të GNL-së.

35. “Operator i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH)” është personi, që kryen veprimtarinë e shpërndarjes. Ai është përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe, nëse është e nevojshme, zhvillimin e sistemit të shpërndarjes në një zonë të caktuar e, ku është e mundur, lidhjen e tij me sistemet e tjera. Gjithashtu, ai është përgjegjës edhe për sigurimin e aftësisë afatgjatë të sistemit, për të përmbushur kërkesat e arsyeshme për shpërndarjen e gazit.

36. “Operator i Sistemit të Transmetimit (OST)” është subjekti, që kryen veprimtarinë e transmetimit dhe është përgjegjës për operimin, sigurimin e mirëmbajtjes dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit në një zonë të caktuar e, ku është e mundur, lidhjen e tij me sistemet e tjera. Ai është përgjegjës për sigurimin e aftësisë afatgjatë të sistemit, për të plotësuar nevojat e arsyeshme për transmetimin e gazit.

37. “Person” është personi fizik ose juridik.

38. “Përdorim” është vënia në funksionim dhe mirëmbajtja, në aspektin teknologjik, të infrastrukturës së sistemit të gazit natyror (tubacione gazsjellësish, impiante GNL-je apo hapësira depozitimi të gazit natyror).

39. “Përdorues i rrjetit ose i sistemit” është personi, që furnizon ose furnizohet nga sistemi.

40. “Pjesëmarrës” janë të gjitha institucionet dhe subjektet që operojnë në sektorin e gazit natyror.

41. “Planifikim afatgjatë” është planifikimi i furnizimit dhe i kapacitetit transmetues e shpërndarës të shoqërive të gazit natyror, mbi baza afatgjata, për përmbushjen e kërkesës për gaz natyror, diversifikimin e burimeve dhe garantimin e furnizimeve të klientëve.

42. “Prodhues” është personi, i cili ushtron veprimtarinë për prodhimin e gazit natyror.

43. “Rigazifikim” është procesi i ngrohjes së GNL-së deri në kthimin e tij në gjendje të gaztë.

44. “Rregulla të praktikës dhe të procedurave” janë rregullat e miratuara nga bordi i komisionerëve të ERE-së, ku përcaktohen procedurat dhe afatet që zbaton ERE-ja.

45. “Rregulla teknike dhe të sigurisë” janë rregullat teknike dhe kriteret e sigurisë, ku përcaktohen kërkesat minimale të projektimit teknik, ndërtimit dhe operimit të sistemeve të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror, të instalimeve të GNL-së, hapësirave të depozitimit, si dhe të linjave direkte.

46. “Rrjet” është një sistem i ndërlidhur tubacionesh.

47. “Rrjet tubacioni në sektorin e kërkim-prodhimit” është çdo tubacion ose rrjet tubacionesh, që operojnë dhe/ose janë ndërtuar si pjesë e një projekti për nxjerrje naftë apo gaz, ose që përdoret për të transportuar gaz natyror nga një apo më shumë projekte të tilla, të një uzine përpunimi, terminal ose terminal fundor detar.

48. “Siguri” është siguri furnizimi me gaz natyror ose/dhe siguri teknike, sipas kontekstit.

49. “Shërbime ndihmëse” janë të gjitha shërbimet, të nevojshme për hyrje dhe operimin e rrjeteve të transmetimit dhe/ose shpërndarjes, instalimet e GNL-së dhe/ose hapësirat e depozitimit, përfshirë balancimin dhe kombinimin e ngarkesës, përjashtuar facilitetet e rezervuara ekskluzivisht për operatorët e sistemeve të transmetimit.

50. “Shoqëri furnizimi” është personi që kryen veprimtarinë e furnizimit.

51. “Shoqëri gazi natyror” është personi që kryen të paktën një prej veprimtarive, si: prodhimin, transmetimin, shpërndarjen, furnizimin, blerjen ose depozitimin e gazit natyror, përfshirë GNL-në dhe që është përgjegjës për detyrat tregtare e teknike dhe/ose përmbajtjen, që lidhen me këto funksione, por nuk përfshin klientët fundorë.

52. “Shoqëri e integruar e gazit natyror” është një shoqëri, vertikalisht ose horizontalisht, e integruar.

53. “Shoqëri horizontalisht e integruar” është një shoqëri gazi natyror, që kryen të paktën një prej veprimtarive, si të prodhimit, transmetimit, shpërndarjes, furnizimit ose depozitimit të gazit natyror dhe të një veprimtarie tjetër, jashtë sektorit të gazit natyror.

54. “Shoqëri vertikalisht e integruar” është një shoqëri gazi natyror ose një grup shoqëri,

marrëdhëniet e të cilave janë përcaktuar në nenin 3(3) të Rregullores së Këshillit (EEC) nr.4064/89, datë 21 dhjetor 1989, për kontrollin e përqendrimeve ndërmjet shoqërive dhe ku shoqëria/grupi në fjalë kryen të paktën njërën prej veprimtarive të transmetimit, shpërndarjes, GNL-së ose depozitimit dhe të paktën njërën prej veprimtarive të prodhimit apo furnizimit të gazit natyror.

55. “Shpërndarje” është transporti i gazit natyror nëpërmjet rrjeteve të tubacionit të shpërndarjes, për livrimin e tij te klientët, pa përfshirë furnizimin.

56. “Sistem” është çdo rrjet transmetimi, shpërndarjeje, impianti GNL-je ose hapësire depozitimi, zotëruar ose operuar nga një shoqëri e gazit natyror, përfshirë *linepack-un*, facilitetet e tij, që sigurojnë shërbimet ndihmëse, si dhe ato që janë të nevojshme për hyrjen në transmetim, shpërndarjen dhe impiantet e GNL-së.

57. “Sisteme të ndërlidhura” janë një numër sistemesh të lidhura me njëra-tjetrën.

58. “Transmetim” është transporti i gazit natyror, nëpërmjet një tubacioni të presionit të lartë, i ndryshëm nga rrjeti i tubacionit në sektorin e kërkim-prodhimit, për livrimin e tij te klientët, pa përfshirë furnizimin.

59. “Tranzit” është transporti i gazit natyror nga një vend tjetër për në një vend të tretë, nëpërmjet sistemit të transmetimit të Republikës së Shqipërisë.

60. “Tregtim” është blerja ose shitja me shumicë e gazit natyror.

KREU II POLITIKAT E SEKTORIT TË GAZIT NATYROR

Neni 4

Politikat e sektorit të gazit natyror

1. Ministria përgjegjëse për energjinë është institucioni më i lartë për formulimin e politikave të zhvillimit të sektorit të gazit natyror.

2. Në kryerjen e përgjegjësive, sipas këtij ligji, ministria, kur e gjykon të arsyeshme, këshillohet me autoritetet e tjera shtetërore të sektorit të energjisë, ERE-në, me pjesëmarrësit në sektorin e gazit natyror, si dhe me partnerët socialë.

3. Ministria përcakton politikat dhe programet për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm e të sigurt të sektorit të gazit natyror.

4. Ministria zhvillon politika dhe programe të paktën për njërën nga çështjet e mëposhtme:

a) për zbatimin e objektivave dhe të politikave energjetike në sektorin e gazit natyror, në përputhje me kërkesat e traktatit për krijimin e Komunitetit të Energjisë;

b) për nxitjen e investimeve në sektorin e gazit natyror, përfshirë edhe lehtësitë e mundshme fiskale;

c) për marrjen e masave të mbrojtjes së mjedisit;

ç) për garantimin e zhvillimit të sigurt dhe të qëndrueshëm të rrjeteve e të instalimeve të tjera të infrastrukturës së gazit natyror;

d) për harmonizimin me standardet dhe rregulloret e Bashkimit Europian në këtë sektor dhe sigurimin e ndërveprimit të sistemeve të gazit natyror të Republikës së Shqipërisë me sistemet rajonale dhe ato europiane;

dh) për zhvillimin e programeve për mbrojtjen e klientëve me të ardhura të pakta, në bashkëpunim me autoritetet dhe institucionet e tjera shtetërore.

5. Ministri, në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, jep lejet profesionale për specialistët, që kryejnë veprimtari projektuese dhe zbatuese në fushat e përcaktuara me këtë ligj, si dhe në fushat e kërkimit, të prodhimit, përpunimit, transportimit, depozitimit dhe tregimit të hidrokarbureve në tërësi.

Neni 5

Siguria e furnizimit me gaz natyror

1. Pjesëmarrësit në tregun e gazit natyror planifikojnë dhe marrin masat për një furnizim të sigurt me gaz natyror, në përputhje me standardet, si dhe janë përgjegjës për furnizimin me gaz natyror, brenda qëllimit të veprimtarisë.

2. Ministria është përgjegjëse për analizën e marrëdhënieve ndërmjet ofertës dhe kërkesës në tregun e gazit natyror, duke bërë parashikime edhe për të ardhmen, për planifikimin e ndërtimit të kapaciteteve shtesë në sistemin e gazit natyror, si dhe për propozimin e marrjen e masave në rastet e situatave të krizave.

3. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton rregullat për sigurinë e furnizimit të garantuar dhe të qëndrueshëm me gaz natyror, ku përcaktohen:

a) kriteret dhe mënyrat e përlllogaritjes së sasive të mjaftueshme të gazit natyror, për një furnizim të qëndrueshëm të klientëve të mbrojtur;

b) programi për reduktimin ose ndërprerjen e furnizimit me gaz natyror të kategorive të veçanta të klientëve në rast krize;

c) përmbajtja e raportit të një furnizuesi të gazit natyror për sigurinë e furnizimit me këtë gaz.

4. ERE-ja është autoriteti përgjegjës për monitorimin e sigurisë së furnizimit.

5. ERE-ja, brenda muajit janar të çdo viti, në bashkëpunim me ministrinë, përgatit dhe publikon një raport për sigurinë e furnizimit me gaz natyror, duke propozuar edhe masat përkatëse.

6. Raporti i përgatitur sipas pikës 5 të këtij neni u bëhet i njohur menjëherë Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit.

Neni 6

Masat mbrojtëse për sigurinë e furnizimit

1. Në rast të një krize të menjëhershme në tregun e energjisë ose kur siguria fizike e personave, aparateve apo instalimeve ose e integritetit të sistemit kërcënohet, ministria, në bashkëpunim me autoritetet përkatëse, ndërmerr masat mbrojtëse të nevojshme, të përkohshme.

2. Masat e marra në rastet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni duhet sjellin efekte negative sa më të vogla të mundshme për funksionimin e tregut të brendshëm dhe të merren vetëm kur janë të nevojshme për shmangien e vështirësive të menjëhershme, që mund të jenë krijuar.

3. Ministri vë në dijeni menjëherë Këshillin e Ministrave dhe, kur e sheh të nevojshme, edhe vendet e tjera, me të cilat ka marrëdhënie bashkëpunimi në sektorin e gazit natyror, për masat mbrojtëse të marra sipas pikës 1 të këtij neni.

4. Ministria njofton institucionet përkatëse të traktatit të krijimit të Komunitetit të Energjisë për masat e marra sipas pikës 1 të këtij neni.

Neni 7

Rregullat teknike dhe të sigurisë në sektorin e gazit natyror

1. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton rregullat teknike dhe kriteret e sigurisë, ku përcaktohen kërkesat minimale të projektimit teknik, ndërtimit dhe operimit të sistemeve të transmetimit e të shpërndarjes së gazit natyror, të instalimeve të GNL-së, hapësirave të depozitimit dhe të linjave direkte, për operimin e sigurt të sistemeve.

2. Përgatitja dhe miratimi i rregullave teknike e i kriterëve të sigurisë, sipas pikës 1 të këtij neni, bëhen brenda 4 vjetëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Deri në çastin e miratimit nga Këshilli i Ministrave të këtyre rregullave, do të zbatohen rregullat dhe kriteret e sigurisë së vendeve të BE-së. Ministri përcakton rregullat që do të zbatohen.

3. Ministri, brenda 3 vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, përcakton rregullat teknike për kryerjen e operacioneve të depozitimit të gazit natyror në vendburimet hidrokarbure ose në hapësirat e tjera nëntokësore, të përshtatshme për këtë qëllim, në përputhje me normativat europiane në këtë fushë.

4. Rregullat teknike, të parashikuara në pikën 3 të këtij neni, përditësohen nga ministria, në funksion të zhvillimit teknik dhe teknologjik të sistemit të depozitimit të gazit natyror.

5. Kontrolli për zbatimin dhe respektimin e rregullave, të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, ushtrohet nga strukturat përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 8

Ndërtimi dhe përdorimi i tubacioneve dhe i infrastrukturës së gazit natyror

1. Ndërtimi dhe përdorimi i tubacioneve për transmetimin dhe shpërndarjen e gazit natyror, instalimeve të GNL-së, depozitave nëntokësore të gazit natyror, linjave direkte, si dhe lidhja e sistemit shqiptar të gazit natyror me sistemet fqinje bëhen me leje të veçantë, të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

2. Leja jepet për një afat 30 vjet, me të drejtë ripërsëritjeje. Mënyra e ripërtëritjes së lejes përcaktohet në marrëveshjen midis dy palëve. Nëse nuk ripërsëritet pas mbarimit të afatit, asetet e ndërtuara i kalojnë në pronësi shtetit shqiptar.

3. Këshilli i Ministrave miraton rregullat për kushtet dhe procedurat e dhënies së lejes. Rregullat mbështeten në kriteret e mosdiskriminimit, të trajtimit të barabartë dhe transparencës.

4. Leja e dhënë sipas pikës 1 të këtij neni nuk përjashton marrjen e të gjitha lejeve të tjera, për një ndërtim të zakonshëm, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KREU III

RREGULLIMI I SEKTORIT TË GAZIT NATYROR

SEKSIONI I

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Neni 9

Autoriteti rregullator

1. ERE-ja është autoriteti rregullator i veprimtarive në sektorin e gazit natyror, me përjashtim të veprimtarisë së kërkimit dhe të prodhimit të këtij gazi.

2. ERE-ja, përveç kompetencave, sipas ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, gëzon dhe çdo kompetencë të dhënë nga ky ligj dhe aktet e tjera ligjore në fuqi.

3. Anëtarët e bordit të komisionerëve të ERE-së dhe personeli teknik, për sa i takon konfliktit të interesave, janë subjekte të dispozitave të nenit 6 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

Neni 10

Buxheti dhe financimi i ERE-së

1. Buxheti i ERE-së krijohet nga burimet financiare të parashikuara në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar dhe nga pagesat e rregullimit, që paguhen nga të licencuarit në sektorin e gazit natyror.

2. ERE-ja përcakton pagesat e aplikimit për licencë dhe pagesat e rregullimit për të licencuarit në sektorin e gazit natyror.

Neni 11

Përgjegjësitë e ERE-së në sektorin e gazit natyror

ERE-ja, si një institucion i pavarur, ka autoritet rregullator në sektorin e gazit natyror, përfshirë, por jo kufizuar, në çështjet e mëposhtme:

1. Përcaktimin dhe miratimin e tarifave, që zbatohen për të llogaritur ose përcaktuar termat dhe kushtet për:

a) lidhjen dhe hyrjen në rrjete, përfshirë tarifat e transmetimit dhe të shpërndarjes. Këto tarifa do të mundësojnë që investimet e nevojshme në rrjete të sigurojnë qëndrueshmërinë e tyre;

b) lidhjen dhe hyrjen në hapësirat e depozitimit, instalimet e GNL-së, shërbimet ndihmëse dhe furnizimin me gaz natyror të klientëve;

c) garantimin e shërbimeve balancuese.

2. Monitorimin e sigurisë së furnizimit, përfshirë, por jo kufizuar, nivelin e kërkesës së ardhshme, të pritshme dhe furnizimin e disponueshëm, kapacitetet potenciale shtesë, të planifikuara ose në ndërtim, cilësinë dhe nivelin e mirëmbajtjes së rrjeteve, si dhe masat për të mbuluar kërkesën pik dhe për t'u përballuar me dështimin e një ose më shumë furnizuesve.

3. Rregullimin dhe garantimin e hyrjes, përfshirë hyrjen e gazit nga burimet e biomasës në sistemet e transmetimit dhe të shpërndarjes, përfshirë:

a) rregullat për menaxhimin dhe alokimin e kapaciteteve të interkonjeksionit, në këshillim me autoritetet rregullatore të vendeve me të cilat është lidhur sistemi ynë;

b) publikimin dhe mënyrën e publikimit të informacionit të mjaftueshëm nga OST-të dhe OSSH-të për interkonjeksionet, përdorimin e rrjetit dhe alokimin e kapacitetit për palët e interesuara, përfshirë tarifat, duke pasur parasysh nevojën për të trajtuar informacionin tregtar konfidencial;

c) çdo mekanizëm për kapacitetet e kufizuara, brenda sistemit kombëtar të gazit natyror;

ç) rregullat për përjashtimet nga detyrimi i ofrimit të hyrjes së palëve të treta, sipas angazhimeve "take-or-pay" dhe marrëveshjeve të tjera ndërmjet shoqërive të sistemit të gazit natyror dhe përdoruesve të sistemit.

4. Zbatimin e detyrimeve të shërbimit publik.

5. Mbrojtjen e konsumatorëve.

6. Përcaktimin e fazave të hapjes së tregut, të kriterëve për dhënien e statusit të klientëve të kualifikuar dhe të afateve kohore për kualifikimin e tyre, në përputhje me detyrimet ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë dhe me kërkesat e tjera ligjore.

7. Garantimin, që klientët e kualifikuar të mund të zgjedhin furnizues të rinj.

8. Kushtet e përgjithshme të furnizimit, përfshirë krijimin e termave dhe të kushteve të përgjithshme kontraktuale transparente.

9. Dhënien, ndryshimin, transferimin dhe heqjen e licencave për shoqëritë e gazit natyror.

10. Miratimin e rregullave, të hartuara nga OST-ja, për balancimin e sistemit të transmetimit të gazit natyror.

11. Miratimin e planeve të investimeve të të licencuarve në sektorin e gazit natyror.

12. Përcaktimin e kërkesave minimale për OST-në, për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit, përfshirë kapacitetin e interkonjeksionit.

13. Miratimin e udhëzimeve të ndarjes së llogarive, për të siguruar se nuk ka ndërsubvencionime ndërmjet veprimtarive në sektor, përfshirë rregullat për mbajtjen dhe auditimin e llogarive të shoqërive të gazit natyror.

14. Ruajtjen e konfidencialitetit të informacionit të ndjeshëm tregtar të shoqërive të gazit natyror dhe të pjesëtarëve të tjerë të këtij sektori.

15. Përcaktimin e mekanizmave dhe të procedurave për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve për shoqëritë e gazit natyror.

16. Përcaktimin e përjashtimeve nga kërkesat e hyrjes ose tarifat për infrastrukturën e re.

17. Vendosjen e standardeve minimale për cilësinë e shërbimit, veçanërisht për kohën që u duhet operatorëve të transmetimit dhe shpërndarjes, për të bërë lidhjet dhe riparimet.

18. Përcaktimin e mekanizmave për të shmangur çdo abuzim me pozicionin dominues, në veçanti në dëm të konsumatorëve dhe çdo sjellje grabitqare.

19. Kërkesat e monitorimit dhe të raportimit të informacionit, që aplikohen për shoqëritë e gazit natyror, për të siguruar një administrim efektiv dhe eficient të këtij ligji.

20. Krijimin e kushteve të barabarta të lojës për të gjithë pjesëmarrësit e tregut të gazit

natyror, duke bashkëpunuar me autoritete të tjera rregullatore dhe, në veçanti, me bordin rregullator dhe me këshillin ministerial të Komunitetit të Energjisë.

Neni 12

Rregullat e praktikës dhe procedurës së ERE-së

ERE-ja, brenda 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, miraton ndryshimin e rregullave të praktikës dhe të procedurës, që rregullojnë procedimet e saj për veprimtaritë në sektorin e gazit natyror, përfshirë, por pa u kufizuar, trajtimin e informacionit konfidencial.

Neni 13

Raportimi

ERE-ja paraqet brenda 31 marsit të çdo viti në Kuvend një raport vjetor për gjendjen në sektorin e gazit natyror, veprimtarinë e vet dhe përfundimet për përgjegjësitë monitoruese, përfshirë një vlerësim për nivelin e transparencës dhe të konkurrencës në treg.

SEKSIONI II

LICENCIMI NË SEKTORIN E GAZIT NATYROR

Neni 14

Licencat dhe procedurat e licencimit

1. ERE-ja lëshon licenca për veprimtaritë e mëposhtme:
 - a) transmetim të gazit natyror;
 - b) shpërndarje të gazit natyror;
 - c) furnizim të gazit natyror;
 - ç) tregtim të gazit natyror;
 - d) operim në hapësirat e depozitimit të gazit natyror;
 - dh) operim në impiantet e GNL-së.
2. Kryerja e njëres prej veprimtarive të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, pa autorizimin e ERE-së, është e paligjshme.
3. ERE-ja i jep licencë për transmetimin e gazit natyror vetëm një personi, për një territor të caktuar.
4. ERE-ja i jep licencë për shpërndarjen dhe furnizimin e klientëve tariforë me gaz natyror vetëm një personi, për një zonë të caktuar shërbimi.

Përcaktimi i zonave të transmetimit dhe të shpërndarjes bëhet nga ERE-ja me udhëzim, në bazë të kriterëve teknike dhe ekonomike.
5. Bashkitë dhe komunat mund t'i ushtrojnë veprimtaritë e përmendura në pikën 1 të këtij neni, kur ato kanë marrë licencë nga ERE-ja.
6. ERE-ja, për dhënien, refuzimin, ndryshimin dhe heqjen e një licence në sektorin e gazit natyror, zbaton kriteret dhe procedurat e parashikuara në nenet 16, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.
7. ERE-ja miraton rregulloren për procedurat e licencimit të veprimtarive të gazit natyror, ku përcakton afatet, formën, mënyrën dhe pagesat e aplikimit për çdo licencë.
8. Për operimin e një linje direkte, nuk është e nevojshme marrja e licencës nga ERE-ja.

Neni 15

Mbajtja e bilanceve të llogarive të të licencuarve

1. Çdo shoqëri e licencuar në sektorin e gazit natyror, që kryen më shumë se një nga

veprimtaritë, që kanë të bëjnë me prodhimin, transmetimin, shpërndarjen, furnizimin dhe operimin e impianteve të GNL-së ose të hapësirave të depozitimit, mban llogari të veçantë për çdo veprimtari, si dhe përgatit bilance llogarish të konsoliduara, në përputhje me praktikatat e kërkuara.

2. Këto shoqëri mbajnë, gjithashtu, llogari të veçanta për veprimtaritë, që nuk lidhen me ato të prodhimit, transmetimit, shpërndarjes, furnizimit, operimit të impianteve të GNL-së dhe hapësirave të depozitimit të gazit natyror.

3. ERE-ja mund të miratojë standarde të njëjta për mbajtjen e llogarive për të gjithë të licencuarit në sektorin e gazit natyror.

4. ERE-ja kontrollon llogaritë e të licencuarve dhe ruan konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregtar të të licencuarve.

Neni 16

Plani i investimeve

1. OST-ja dhe OSSH-ja përgatisin planet afatgjata të investimeve për zhvillimin, ndërtimin dhe modernizimin e sistemit të transmetimit e të shpërndarjes së gazit natyror, për një periudhë jo më të shkurtër se 5 vjet.

2. Planet e investimeve paraqiten për miratim në ERE.

3. Planet afatgjata të investimeve vlerësohen sipas një analize të vlerës së përfitimeve.

4. ERE-ja miraton rregulla të veçanta për mënyrën, formën dhe afatet e paraqitjes së planeve të investimeve, sipas pikës 1 të këtij neni.

SEKSIONI III

TARIFAT E SEKTORIT TË GAZIT NATYROR

Neni 17

Veprimtaritë me tarifa të rregulluara

1. ERE-ja përcakton tarifat për hyrjen në rrjetin e transmetimit ose të shpërndarjes, për pagesën e lidhjes me rrjetin e transmetimit ose të shpërndarjes, për hyrjen në hapësirat e depozitimit dhe impiantet e GNL-së, shërbimet ndihmëse, balancimin dhe furnizimin e klientëve tariforë.

2. Veprimtaritë konkurruese përfshijnë shitjen me shumicë të gazit ndërmjet furnizuesve dhe shitjen me pakicë ndërmjet furnizuesve dhe klientëve të kualifikuar, çmimet e të cilave përcaktohen bazuar në ofertën dhe kërkesën.

3. Nëse ERE-ja vlerëson se hapësira e depozitimit, shërbimet balancuese ose shërbimet ndihmëse operojnë në një treg mjaftueshmërisht konkurrues, mund të lejojë përcaktimin e çmimeve në bazë të tregut.

Neni 18

Vendosja e tarifave

1. Tarifat dhe mënyrat e llogaritjes së tyre janë jodiskriminuese e transparente. Ato marrin parasysh nevojën për integritetin e sistemit dhe reflektojnë kostot e realizuara në mënyrë efçente, përfshirë kthimin e duhur të investimeve.

2. Tarifat mundësojnë tregtimin dhe konkurrencën efçente të gazit, duke shmangur ndërsuvencionimet ndërmjet përdoruesve të sistemit dhe sigurojnë incentiva për investime.

3. Tarifat nuk kufizojnë likuiditetin e tregut apo shtrembërojnë tregtinë ndërkufitare të sistemeve të ndryshme të transmetimit.

4. ERE-ja miraton tarifa që mbulojnë, në mënyrë efçente, kostot e realizuara për veprimtaritë e rregulluara, duke siguruar një normë kthimi të arsyeshme të kapitalit të investuar në këto veprimtari dhe stimuluar zhvillimin e kapaciteteve të transmetimit, depozitimit dhe

shpërndarjes, përmes tërheqjes së investimeve të huaja dhe transferimit të teknologjisë.

5. Mënyra e llogaritjes së tarifave mund të përfshijë incentivat e duhura, për të përmirësuar shërbimin dhe nxitur një balancim optimal të ngarkesës.

6. ERE-ja publikon në Fletoren Zyrtare vendimin për çdo propozim tarife.

7. Shoqëritë e gazit natyror i shpallin tarifat e tyre, të paktën 15 ditë përpara hyrjes së tyre në fuqi, në përputhje me rregullat e ERE-së.

Neni 19

Tarifat e balancimit

1. OST-ja paraqet për miratim në ERE tarifat e balancimit, në bazë të kriterëve objektive, që pasqyrojnë nevojat reale të sistemit, në përputhje me burimet e disponueshme të saj. Tarifat e balancimit përcaktohen në përputhje me kriteret e mëposhtme:

a) me nivelet e tolerancës, të cilat janë jodiskriminuese dhe transparente dhe pasqyrojnë aftësitë teknike të sistemit të transmetimit e nevojat reale të këtij sistemi;

b) me tarifat e disbalancës, që duhet të jenë, sa të jetë e mundur, të mbështetura në kosto, ndërkohë që sigurojnë incentivat e duhura balancuese, për të balancuar injektimin dhe marrjen e gazit natyror, si dhe shmangin ndërsubvencionimet ndërmjet përdoruesve të rrjetit dhe pengesat e hyrjes për përdoruesit e rinj të rrjetit;

c) me vlerat e penalizimeve për përdoruesit e rrjetit, që nuk janë në përputhje me rregullat e balancimit, të miratuara nga ERE-ja, të cilat duhet të jenë më të mëdha se kostot aktuale të balancimit, por vetëm deri në atë masë, për të siguruar një operator rrjeti eficient dhe strukturalisht të ngjashëm me të tjerët. Penalitetet, që kalojnë kostot e balancimit, të realizuara në mënyrë efektive, u rishpërndahen përdoruesve të sistemit pa diskriminim.

2. OST-ja publikon informacion të mjaftueshëm në kohë dhe të besueshëm për gjendjen e balancimit të përdoruesve të rrjetit, për t'u mundësuar përdoruesve të sistemit ndërmarrjen në kohë të veprimeve korrigjuese. Niveli i informacionit të dhënë reflekton nivelin e informacionit të disponueshëm nga OST-ja.

3. OST-ja publikon të gjithë termat dhe kushtet, përfshirë rregullat dhe tarifat për sigurimin e shërbimeve të balancimit.

KREU IV

VEPRIMTARITË NË SEKTORIN E GAZIT NATYROR

SEKSIONI I

TRANSMETIMI I GAZIT NATYROR

Neni 20

Operatori i sistemit të transmetimit (OST)

1. Veprimtaria e transmetimit dhe dispeçerimit të gazit natyror është veprimtari me interes publik dhe kryhet nga OST-ja në një territor të caktuar, sipas të drejtave dhe përgjegjësive të përcaktuara në këtë ligj.

2. OST-ja është e pavarur nga veprimtaritë e tjera, që nuk lidhen me transmetimin, të paktën nga pikëpamja e organizimit dhe vendimmarrjes.

3. OST-ja operon në përputhje me parimet e sanksionuara në këtë ligj dhe me parimet e objektivitetit, të transparencës dhe mosdiskriminimit.

Neni 21

Përgjegjësitë e OST-së

1. OST-ja zotëron, operon, ndërton dhe mirëmban sistemin e transmetimit të gazit natyror dhe siguron, në përputhje me kushtet ekonomike, kapacitete të mjaftueshme për të plotësuar kërkesën e arsyeshme për transmetim të gazit natyror në një territor të caktuar.

2. OST-ja siguron shërbimin e transmetimit të gazit natyror, në përputhje me kushtet e licencës dhe me rregullat e ERE-së.

3. OST-ja garanton balancimin e këtij sistemi, sipas rregullave balancuese, të cilat ia paraqet për miratim ERE-së.

4. OST-ja vepron në mënyrë të hapur, transparente dhe objektive, duke shmangur diskriminimin ndërmjet përdoruesve të sistemit ose klasave të përdoruesve të sistemit, sidomos në favor të shoqërive të lidhura me të.

5. OST-ja përgatit marrëveshjet, që miratohen nga ERE-ja, për operimin teknik në kufi, kur furnizuesi është një eksportues ose një përfitues nga tranzitimi i gazit në territorin e Republikës së Shqipërisë.

6. OST-ja u siguron çdo operatori tjetër të sistemit të transmetimit, çdo OSSH-je, çdo operatori të impiantit të GNL-së, OST-ve fqinje ose shoqërive të tjera të licencuara të gazit natyror informacion të mjaftueshëm, për të siguruar ndërveprimin e sigurt dhe eficient të sistemeve të ndërlidhura.

7. OST-ja u siguron përdoruesve të sistemit informacion të hollësishëm publik, të kuptueshëm, qartësisht të matshëm dhe lehtësisht të arritshëm për shërbimet e ofruara, kushtet e shërbimit, dhe informacionin e nevojshëm teknik, për t'u mundësuar një hyrje efektive në rrjet, përfshirë, por jo kufizuar, kapacitetet teknike, të kontraktuara dhe të disponueshme, me përjashtim të informacionit konfidencial të miratuar nga ERE-ja.

8. OST-ja ruan konfidencialitetin e çdo informacioni të ndjeshëm tregtar.

Neni 22

Hyrja e palëve të treta në sistemin e transmetimit

1. OST-ja u siguron hyrje pa diskriminim të palëve të treta në sistemin e transmetimit, brenda kufijve të kapaciteteve transmetuese dhe kërkesave të rregullave teknike.

2. OST-ja publikon kushtet dhe termat e miratuar nga ERE-ja, përfshirë rregullat dhe tarifatat, për sigurimin e hyrjes së palëve të treta në sistemin e transmetimit.

3. OST-ja mund ta refuzojë hyrjen në sistemin e transmetimit për mungesë kapaciteti ose kur hyrja mund të shkaktojë efekte negative në zbatimin e detyrimit të shërbimit publik, sipas dispozitave të nenit 45 të këtij ligji, si dhe vështirësi serioze, ekonomike e financiare, për kontratat “*take-or-pay*”, të cilat kanë qenë efektive përpara kërkesës për hyrje në sistem.

4. Për çdo refuzim për akses në sistemin e transmetimit, OST-ja paraqet shkaqet e refuzimit dhe vë në dijeni, me shkrim, brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës, palën, së cilës i është refuzuar hyrja.

5. Personi, të cilit i është refuzuar hyrja në sistemin e transmetimit, ose që nuk është dakord me termat dhe kushtet e hyrjes, mund të ankohet në ERE.

6. ERE-ja përcakton procedurat, përfshirë afatin kohor, për shqyrtimin e çdo ankese të përmendur në pikën 5 të këtij neni.

7. Vendimi i ERE-së, në rast se nuk apelohej në gjykatë, është i detyrueshëm për palët.

Neni 23

Tranzitimi

1. Tranzitimi i gazit natyror kryhet nga OST-ja, në përputhje me këtë ligj dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi, si dhe me traktatet e marrëveshjet ndërkombëtare, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

2. OST-ja mund të ndërmarrë zhvillimin e kapaciteteve tranzituese, në përputhje me udhëzimet dhe politikat e Qeverisë Shqiptare e me kërkesat e traktatit të krijimit të Komunitetit të Energjisë.

3. Kontratat e tranzitimit dhe çdo alokim kapaciteti për këtë qëllim realizohen në përputhje me kërkesat e licencës dhe me rregullat e ERE-së, për të drejtat e palëve të treta për akses në rrjet.

Neni 24

Përgjegjësitë e OST-së për operimin në hapësirat depozituese

1. Kur OST-ja operon në hapësirat depozituese, mund të ndërtojë e t'i mirëmbajë ato, për të siguruar furnizim të qëndrueshëm dhe eficient të klientëve, sipas ndryshimeve sezonale, ditore dhe orare të konsumit, për një balancë fizike të sistemit, për të përmbushur detyrimet e shërbimit publik, si dhe për të siguruar kapacitetin e depozitimit për klientët e kualifikuar.

2. Hyrja e palëve të treta në hapësirat e depozitimit garantohet në përputhje me kërkesat e licencës dhe rregullat e ERE-së.

3. Nëse OST-ja operon edhe në hapësira depozituese, ajo mban llogari plotësisht të ndara për të dy veprimtaritë që kryen.

Neni 25

Kodi i rrjetit të transmetimit

1. ERE-ja vendos që të gjitha ose një pjesë e rregullave dhe e rregulloreve për operimin e sistemit të transmetimit të përfshihen në kodin e rrjetit të transmetimit.

2. Kodi i rrjetit të transmetimit propozohet nga OST-ja, pas këshillimeve me pjesëtarët e tjerë të sektorit dhe miratohet nga ERE-ja. OST-ja e publikon kodin në një vend lehtësisht të arritshëm nga publiku dhe në faqen e saj elektronike.

3. Pavarësisht nga propozimi i OST-së, ERE-ja, nën autoritetin e vet, mund të vendosë që kodi i rrjetit të transmetimit të përfshijë dispozitat e mëposhtme:

a) termat, kushtet, hollësitë teknike dhe specifikimet minimale teknike për hyrjen e përdoruesve në sistemin e transmetimit;

b) procedurat, termat, kushtet dhe kufizimet për angazhimin dhe rishitjen e kapacitetit të rrjetit të transmetimit dhe të GNL-së ose për hapësirat e depozitimit për përdoruesit, si dhe për caktimin e mëtejshëm të kapaciteteve të angazhuara të transmetimit dhe depozitimit për përdoruesit e tjerë;

c) menaxhimin e pikave të injektimit të gazit natyror në sistemin e transmetimit;

ç) procesin e matjes dhe të përcaktimit të specifikimeve e kushteve të cilësisë, për pranimin e livrimit të gazit natyror;

d) procedurat e alokimit të sasive të matura të gazit natyror për përdoruesit, në pikat e injektimit dhe të marrjes së gazit natyror të sistemit;

dh) planifikimin e mirëmbajtjen e sistemit të transmetimit dhe detyrimet përkatëse të OST-së e të përdoruesve të sistemit;

e) procedurat për përgatitjen e planit të zhvillimit të sistemit të transmetimit dhe për monitorimin e kontrollin e zbatimit të tij, si dhe të gjitha hollësitë për zhvillimin e sistemit të transmetimit;

ë) mekanizmat e menaxhimit të kufizimeve (ngushtimeve);

f) procedurat e balancimit;

g) të gjitha çështjet, që lidhen me kontratat e angazhuara të transmetimit, kërkesën, që një pjesë e kësaj kontrate t'u kushtohet nevojave për balancimin e ngarkesës dhe detyrimeve të shërbimit publik, kufizimet e kapacitetit maksimal, që mund të angazhohen për të njëjtin përdorues dhe për të njëjtat pika injektimi, çdo përjashtim për kontratat ekzistuese, lëshimin e kapacitetit sipas këtyre kontratave, nëse nuk janë përdorur dhe transferimin e të drejtave;

gj) kriteret, sipas të cilave furnizimi i konsumatorëve mund të ndërpritet sipas prioritetit, për arsye të sigurisë së furnizimit;

h) procedurat për zgjidhjen jashtë sistemit gjyqësor të mosmarrëveshjeve ndërmjet

përdoruesve të sistemit të transmetimit dhe OST-së;

i) rregullat për transaksionet e OST-së me përdoruesit e sistemit dhe, veçanërisht, llogaritë që duhen mbajtur nga OST-ja për këtë qëllim;

j) të gjitha çështjet e tjera për menaxhimin, operimin dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit.

SEKSIONI II SHËRNDARJA E GAZIT NATYROR

Neni 26

Operatori i sistemit të shpërndarjes (OSSH)

1. OSSH-ja ushtron veprimtarinë e shpërndarjes së gazit natyror, si një veprimtari me interes publik, në një territor të caktuar, në përputhje me të drejtat dhe përgjegjësitë e përcaktuara në këtë ligj.

2. Veprimtaria e OSSH-së është e pavarur nga veprimtaritë e tjera, që nuk lidhen me shpërndarjen, të paktën nga pikëpamja e organizimit dhe e vendimmarrjes.

3. OSSH-ja operon në rrjetin e shpërndarjes, në përputhje me parimet e përcaktuara në këtë ligj dhe me parimet e objektivitetit, të transparencës dhe mosdiskriminimit.

4. Asnjë shoqëri tjetër nuk ka juridiksion apo autoritet ose të drejtën të zotërojë asete në fushën e shpërndarjes së gazit në një territor të caktuar pa autorizimin e ERE-së.

Neni 27

Përgjegjësitë e OSSH-së

1. OSSH-ja zotëron, operon, ndërton dhe mirëmban sistemin e shpërndarjes së gazit natyror dhe siguron, brenda mundësive ekonomike, kapacitete të mjaftueshme, për të plotësuar kërkesën e arsyeshme për shpërndarjen e gazit natyror në një territor të caktuar.

2. OSSH-ja siguron një shpërndarje, të qëndrueshme dhe eficiente, të gazit natyror, në përputhje me kushtet e licencës dhe me rregullat e ERE-së.

3. OSSH-ja është e detyruar të lidhë në rrjetin e shpërndarjes çdo klient, që ndodhet në zonën e shpërndarjes dhe që e kërkon këtë, mbështetur në kritere objektive dhe transparente, me kusht që sistemi i shpërndarjes të ketë kapacitet të mjaftueshëm dhe të plotësojë të gjitha kushtet e tjera teknike dhe tregtare.

4. OSSH-ja, ndaj të gjithë përdoruesve të sistemit vepron në një mënyrë të hapur, transparente dhe objektive, duke shmangur diskriminimin ndërmjet tyre ose klasave të përdoruesve, sidomos në favor të shoqërive të lidhura me të.

5. OSSH-ja u siguron përdoruesve të këtij sistemi informacion të hollësishëm publik, të kuptueshëm, qartësisht të matshëm dhe lehtësisht të arritshëm, për shërbimet e ofruara, kushtet e shërbimit, si dhe një informacion të nevojshëm teknik, për një hyrje efektive në rrjet, mbi baza të rregullta dhe të vazhdueshme, në përputhje me përjashtimet nga informacioni konfidencial të miratuar nga ERE-ja;

6. OSSH-ja publikon kushtet dhe termat e miratuar nga ERE-ja, përfshirë rregullat dhe tarifatat për sigurimin e shërbimeve të shpërndarjes.

7. OSSH-ja ruan konfidencialitetin e çdo informacioni të ndjeshëm tregtar të përdoruesve të sistemit të shpërndarjes.

Neni 28

Hyrja e palëve të treta në sistemin e shpërndarjes

1. OSSH-ja u siguron hyrje pa diskriminim palëve të treta në sistemin e shpërndarjes, brenda kufijve të kapaciteteve të shpërndarjes dhe sipas rregullave teknike.

2. OSSH-ja publikon kushtet dhe termat e miratuar nga ERE-ja, përfshirë rregullat dhe tarifatat, për sigurimin e hyrjes së palëve të treta në sistemin e shpërndarjes.

3. OSSH-ja refuzon hyrjen në sistemin e shpërndarjes, për mungesë kapaciteti ose kur hyrja në këtë sistem mund të shkaktojë efekte negative në zbatimin e detyrimit të shërbimit publik ose vështirësi serioze, ekonomike dhe financiare për kontratat “*take-or-pay*”, që kanë qenë efektive përpara kërkesës për hyrje në sistem.

4. Për çdo refuzim për akses në sistemin e shpërndarjes, OSSH-ja paraqet shkaqet e arsyetuara për këtë refuzim dhe vë në dijeni, me shkrim, brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për akses, palën, së cilës i është refuzuar hyrja.

5. Personit, të cilit i është refuzuar hyrja në sistemin e shpërndarjes ose nuk ka qenë dakord me termat dhe kushtet e hyrjes, mund të ankohet në ERE. Kur vendimi i ERE-së nuk apelohehet në gjykatë, është i detyrueshëm për palët.

Neni 29

Kodi i rrjetit të shpërndarjes

1. ERE-ja vendos që të gjitha ose një pjesë e rregullave të saj për operimin e sistemit të shpërndarjes të përfshihen në kodin e rrjetit të shpërndarjes.

2. Kodi i rrjetit të shpërndarjes propozohet nga OSSH-ja pas këshillimit me pjesëmarrësit e sektorit dhe partnerët socialë, nëse ka dhe miratohet nga ERE-ja. OSSH-ja publikon kodin në një vend lehtësisht të arritshëm nga publiku dhe në faqen e vet elektronike.

3. ERE-ja vendos, me autoritetin e vet, që kodi i rrjetit të shpërndarjes të përfshijë të gjitha dispozitat për menaxhimin, operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të shpërndarjes dhe kushtet e përgjithshme të furnizimit, si aplikimin për hyrje në rrjetin e shpërndarjes, parapagimin për hyrjen në rrjet, nëse ekziston, matjen, faturimin, si ndryshohet një furnizues, në rast se klienti fundor është një klient i kualifikuar dhe i lidhur në rrjetin e shpërndarjes, si përfundohet një kontratë, forca madhore etj.

SEKSIONI III

PRODHIMI I GAZIT NATYROR

Neni 30

Prodhuesit

1. Çdo person i angazhuar në veprimtarinë e prodhimit të gazit natyror është subjekt i ligjit nr.7746, datë 28.7.1993 “Për hidrokarburet (Kërkim dhe prodhim)”, të ndryshuar.

2. Prodhuesit, që kanë nënshkruar një marrëveshje hidrokarbure, sipas dispozitave të ligjit nr.7746, datë 28.7.1993 “Për hidrokarburet (Kërkim dhe prodhim)”, të ndryshuar, mund të kërkojnë të lidhen me rrjetin e transmetimit ose të shpërndarjes së gazit natyror, në përputhje me kushtet dhe standardet teknike, të përcaktuara në kodin e transmetimit ose në kodin e shpërndarjes së gazit natyror. Shpenzimet për këto lidhje përballohen nga prodhuesi.

3. Prodhuesit mund të ndërtojnë linja direkte, për të përmbushur nevojat vetjake ose për të furnizuar një apo më shumë klientë të kualifikuar.

4. Prodhuesit e gazit natyror mund të kryejnë veprimtari të tregtimit ose të furnizimit të klientët e kualifikuar të gazit natyror, sipas dispozitave të këtij ligji, pasi të jenë licencuar nga ERE-ja.

SEKSIONI IV

DEPOZITIMI I GAZIT NATYROR

Neni 31

Veprimtaria e depozitimit

1. Veprimtaria e depozitimit të gazit natyror kryhet nga çdo shoqëri, që ka në dispozicion

hapësira depozituese të gazit natyror, sipas marrëveshjes hidrokarbure, të lidhur në përputhje me dispozitat e ligjit nr.7746, datë 28.7.1993 “Për hidrokarburet (Kërkim dhe prodhim)”, të ndryshuar, ose me ndonjërin prej formave të tjera, të parashikuara me ligj.

2. Çdo zotërues i hapësirave të depozitimit është i detyruar t’i administrojë këto hapësira, për të garantuar optimizimin e tyre dhe sigurinë e sistemit.

3. Zotëruesit e hapësirave të depozitimit janë të detyruar t’u sigurojnë dhe furnizojnë shërbimet e depozitimit të gazit natyror personave, që bëjnë një kërkesë për përdorimin e kapaciteteve të depozitimit, me kusht që këto shërbime të jenë teknikisht dhe ekonomikisht të realizueshme, sipas kriterëve të vendosura.

Neni 32

Hyrja në hapësirat e depozitimit

1. Hyrja në hapësirat e depozitimit lejohet kur është e nevojshme nga pikëpamja teknike dhe ekonomike për furnizimin eficient të klientëve.

2. Dispozitat e pikës 1 të këtij neni nuk zbatohen për shërbimet ndihmëse dhe depozitimet e përkohshme, të lidhura me instalimet e GNL-së e të nevojshme për procesin e rigazifikimit dhe livrimin e mëtejshëm në sistemin e transmetimit.

3. Shoqëritë e gazit natyror dhe klientët e kualifikuar kanë të drejtë hyrjeje në hapësirat e depozitimit, në bazë të tarifave të publikuara ose të termave e kushteve të tjera për përdorimin e tyre.

4. ERE-ja përcakton kriteret dhe përparësitë e hyrjes në hapësirat e depozitimit, në kushte të barabarta, jodiskriminuese dhe të paanshme, si dhe detyrimet e subjekteve, që kryejnë veprimtarinë e depozitimit.

5. ERE-ja miraton një kod për rregullimin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror.

SEKSIONI V

OPERIMI I IMPIANTEVE TË GNL-SË

Neni 33

Operatori i sistemit të impiantit të GNL-së

Operatori i sistemit të impiantit të GNL-së mund të jetë një person, i cili pajiset me licencë për kryerjen e veprimtarisë së operimit të impianteve të GNL-së.

Neni 34

Detyrat e operatorit të sistemit të impiantit të GNL-së

Operatori i sistemit të impiantit të GNL-së ka për detyrë:

- a) operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sigurt, të qëndrueshëm dhe eficient të impiantit;
- b) miratimin për përdorimin e impianteve;
- c) lidhjen e impiantit me sistemin e transmetimit, në përputhje me rregullat teknike të këtij sistemi dhe me rregullat për përdorimin e impianteve;
- ç) vendosjen dhe sigurimin e një sistemi matës të gazit, që hyn dhe del nga impianti, si dhe të parametrave të cilësisë së gazit;
- d) shkarkimin dhe rigazifikimin e GNL-së, sipas kontratave të nënshkruara;
- dh) sigurimin e kushteve të njëjta dhe jodiskriminuese për hyrje në impiant, sipas dispozitave të këtij ligji dhe kushteve të përgjithshme të furnizimit me gaz natyror;
- e) përgatitjen e një plani pesëvjeçar për zhvillimin e impiantit, të cilin e paraqet për miratim në ERE;
- ë) sigurimin e informacionit të rregullt për operatorin e sistemit të transmetimit, për funksionimin dhe zhvillimin eficient të sistemeve të ndërlidhura;

f) sigurimin e informacionit të rregullt për pjesëmarrësit e tregut të gazit për vëllimin, datën e mbylljes së operimit dhe reduktimin e pritshëm të kapaciteteve të impiantit;

g) sigurimin e mbrojtjes së informacionit konfidencial, me karakter tregtar, të marrë gjatë kryerjes së biznesit të tij.

Neni 35

Të drejtat e operatorit të sistemit të impiantit të GNL-së

Operatori i sistemit të impiantit të GNL-së ka të drejtë:

- a) të refuzojë hyrjen në impiant, në rastet e parashikuara në nenin 40 të këtij ligji;
- b) të blejë gaz natyror për nevojat e veta dhe për kompensimin e humbjeve në impiant;
- c) të kufizojë ose të ndalojë përkohësisht shkarkimin dhe rigazifikimin e GNL-së:
 - i) në rast të një kërcënimi të drejtpërdrejtë të jetës njerëzore, shëndetit dhe pasurisë;
 - ii) në rast të një situatë krize;
 - iii) në raste të punimeve të planifikuara të mirëmbajtjes dhe të rindërtimit të impianteve;
 - iv) kur një përdorues nuk respekton detyrimet e tij kontraktuale.

SEKSIONI VI

FURNIZIMI I GAZIT NATYROR

Neni 36

Furnizuesit

1. Çdo person i angazhuar në furnizimin e gazit natyror pajiset me një licencë nga ERE-ja dhe është subjekt i autoritetit rregullues të saj.

2. Furnizimi me gaz natyror i klientëve tariforë kryhet nga furnizuesi publik. Furnizimi publik është përgjegjësi e OSSH-së për të gjithë klientët tariforë, që ndodhen në territorin, për të cilin është licencuar.

3. Klientët e kualifikuar furnizohen nga çdo furnizues i kualifikuar, i licencuar nga ERE-ja dhe i zgjedhur prej tyre.

4. Furnizuesit publikë, që furnizojnë me gaz natyror klientët tariforë, kryejnë edhe funksionet e furnizuesit të alternativës së fundit.

Neni 37

Kontrata e furnizimit publik

1. ERE-ja miraton një kontratë standarde të furnizimit publik, e cila parashikon garantimin e një furnizimi të vazhdueshëm dhe të sigurt me gaz natyror të klientëve tariforë.

2. Furnizuesi publik është i detyruar të lidhë një kontratë të furnizimit publik me çdo klient tarifor, që kërkon të lidhet me sistemin e transmetimit dhe të shpërndarjes për t'u furnizuar me gaz natyror.

3. Furnizuesi publik mund të refuzojë fillimin e furnizimit me gaz natyror të një klienti tarifor ose të ndërpresë furnizimin, nëse:

a) tubacioni i lidhjes ose pajisjet e klientit kërcënojnë jetën apo shëndetin e njerëzve ose sigurinë e pronës;

b) klienti nuk ka përbushur detyrimet, sipas kontratës standarde të furnizimit publik, pavarësisht njoftimit nga furnizuesi për këto detyrime.

4. Furnizimi i një klienti refuzohet përderisa do të ekzistojnë kushtet, që shërbejnë si bazë për refuzimin sipas pikës 3 të këtij neni.

5. Furnizuesi e ndërpret furnizimin e klientëve në situatat e forcës madhore.

Neni 38

Klientët e kualifikuar

1. Klientë të kualifikuar janë:
 - a) klientët fundorë, që konsumojnë gjatë një viti më shumë se sasia e përcaktuar nga ERE-ja;
 - b) centralet, që konsumojnë gaz natyror për prodhimin e energjisë elektrike;
 - c) centralet, që konsumojnë gaz natyror për prodhimin e kombinuar të energjisë elektrike dhe energjisë termike.
2. Klientët fundorë, që përfshihen në njërën nga tri kategoritë e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, mund të zgjedhin të mbeten klientë tariforë dhe të furnizohen nga OSSH-ja, me të cilën janë lidhur.
3. Në përcaktimin e sasisë së gazit natyror, të konsumuar gjatë një viti nga klienti i kualifikuar, ERE-ja merr parasysh mundësitë teknike të sistemit të gazit natyror dhe angazhimet ndërkombëtare të Shqipërisë.

Neni 39

Matja e gazit natyror të furnizuar

1. Gazi natyror, i përdorur nga klienti, matet nga OSSH-ja, sipas regjistrimeve të aparateve matëse. Instalimi, mirëmbajtja dhe verifikimi i saktësisë së matësit bëhen nga OSSH-ja me shpenzimet e veta.
2. ERE-ja mund t'i kërkojë OSSH-së të kryejë kontrollet e aparateve matëse për çdo kategori klientësh. Klientët janë të detyruar të mundësojnë leximin dhe mbikëqyrjen e aparateve matëse të gazit natyror.
3. Çdo ndërhyrje në sistemin e matjes është e ndaluar dhe ndëshkohet, sipas akteve ligjore në fuqi.
4. ERE-ja miraton rregulla të veçanta për sistemet e matjes dhe matjen.

Neni 40

Përfshirjet për infrastrukturën e re

1. Infrastrukturat e reja kryesore të gazit natyror, si linjat e interkonjeksionit ndërmjet vendeve, instalimet e GNL-së dhe hapësirat e depozitimit mund të përfshihen prej ERE-së pas kërkesës së tyre, nga dispozitat e kërkesave të hyrjes, sipas neneve 23 pika 3, 24 pika 2, 32 e 34 shkronja "dh" të këtij ligji, përfshirë tarifën e aplikueshme, me kusht që:
 - a) investimet të përmirësojnë konkurrencën në furnizimin me gaz dhe të rrisin sigurinë e furnizimit;
 - b) niveli i riskut lidhur me këto investime është i tillë, që këto investime nuk do të bëheshin nëse nuk jepet një përfshirje;
 - c) infrastruktura të zotërohet nga një person, i cili është i ndarë, të paktën nga pikëpamja e formës ligjore, nga operatorët e sistemit, ku do të ndërtohet infrastruktura;
 - ç) tarifën t'u ngarkohen përdoruesve të kësaj infrastrukture;
 - d) përfshirja të mos dëmtojë konkurrencën ose funksionimin efektiv të tregut të brendshëm të gazit natyror, ose funksionimin eficient të sistemit të rregulluar, ku është lidhur infrastruktura.
2. Pika 1 e këtij neni mund të zbatohet edhe në rritjen e konsiderueshme të kapacitetit të infrastrukturës ekzistuese dhe në modifikimet e saj, që mundëson zhvillimin e burimeve të reja të furnizimit me gaz natyror.
3. ERE-ja vendos, rast pas rasti, për përfshirjen, siç përcaktohet në pikat 1 e 2 të këtij neni, duke marrë parasysh kriteret e mëposhtme:
 - a) ERE-ja kërkon mendimin e ministrit për kërkesën për një përfshirje;
 - b) përfshirja mund të mbulojë të gjithë ose një pjesë të infrastrukturës së re, të infrastrukturës ekzistuese, me rritje të konsiderueshme të kapacitetit ose modifikimin e infrastrukturës ekzistuese;
 - c) në marrjen e vendimit për dhënien e një përfshirje, rast pas rasti, merret parasysh

nevoja për të vendosur kushte për kohëzgjatjen e përjashtimit dhe të hyrjes jodiskriminuese në linjën e interkonjeksionit;

ç) në marrjen e vendimit për kushtet në këtë pikë, ERE-ja merr parasysh veçanërisht kohëzgjatjen e kontratës, kapacitetin shtesë që do të ndërtohet, ose modifikimin e kapacitetit ekzistues, afatin e parashikuar të projektit dhe veçoritë kombëtare;

d) kur miraton një përjashtim, ERE-ja vendos për rregullat e mekanizmat për menaxhimin dhe alokimin e kapacitetit, të cilët nuk pengojnë implementimin e kontratave afatgjata;

dh) në rastin e një linje interkonjeksioni, çdo vendim për përjashtim merret pas këshillimit me vendet e tjera ose autoritetet rregullatore përkatëse.

4. Vendimi për përjashtim, përfshirë çdo kusht që mund të vendoset, arsyetohet siç duhet dhe publikohet në Fletoren Zyrtare. Pa nxjerrë informacionin e ndjeshëm tregtar, vendimi përmban:

a) arsyet e hollësishme, në bazë të të cilave ERE-ja ka dhënë përjashtimin, përfshirë informacionin financiar, që justifikon nevojën për përjashtimin;

b) analizën e bërë për efektin mbi konkurrencën dhe funksionimin efektiv të tregut të brendshëm të gazit natyror, që rezultojnë nga dhënia e përjashtimit;

c) arsyet për periudhën kohore dhe pjesën e kapacitetit total të infrastrukturës së gazit natyror në fjalë, për të cilën është dhënë përjashtimi;

ç) kur përjashtimi lidhet me një linjë interkonjeksioni, rezultatin e këshillimit me vendet ose autoritetet rregullatore përkatëse;

d) kontributin e infrastrukturës në diversifikimin e furnizimit me gaz.

5. Për çdo vendim përjashtimi, sipas këtij neni, ERE-ja njofton menjëherë Komisionin European.

Neni 41

Përjashtimet për angazhimet e kontratave “take-or-pay”

1. Nëse një shoqëri e gazit natyror përballet ose vlerëson se do të përballet me vështirësi serioze, ekonomike dhe financiare, për shkak të angazhimeve të saj “take-or-pay”, të përfshira në një ose më shumë kontrata blerjeje gazi natyror, ajo mund të aplikojë në ERE për një përjashtim të përkohshëm nga detyrimi, për të siguruar hyrjen e palëve të treta. Aplikimi paraqitet, rast pas rasti, si para edhe pas refuzimit të hyrjes në sistem, sipas zgjedhjes së shoqërisë së gazit natyror. Aplikimi shoqërohet me një informacion për natyrën dhe përmasat e problemit, si dhe për masat e marra nga një shoqëri, për ta zgjidhur atë.

2. Nëse nuk ka një zgjidhje alternative, lidhur me situatën e përshkruar në pikën 1 të këtij neni, ERE-ja vendos të miratojë një përjashtim, duke pasur parasysh:

a) objektivin e arritjes së një tregu gazi jodiskriminues, transparent dhe konkurrues;

b) nevojën e përmbushjes së detyrimeve të shërbimit publik dhe të sigurimit të sigurisë së furnizimit;

c) pozicionin e shoqërisë së gazit natyror në treg dhe gjendjen aktuale të konkurrencës;

ç) vështirësitë ekonomike dhe financiare, me të cilat përballen shoqëritë e gazit natyror, OST-ja ose klientët e kualifikuar;

d) datën e nënshkrimit dhe termat e kontratës ose të kontratave në fjalë, përfshirë masën, në të cilën ato lejojnë ndryshimet e tregut;

dh) përpjekjet e bëra për të gjetur një zgjidhje të problemit;

e) masën, kur shoqëria pranon angazhimet “take-or-pay”, që mund të kishte parashikuar, në mënyrë të arsyeshme, duke marrë parasysh dispozitat e këtij ligji, që këto vështirësi serioze do të kishin lindur;

ë) nivelin e lidhjes së sistemit me sistemet e tjera dhe shkallën e ndërveprimit të këtyre sistemeve;

f) efektet që do të ketë në dhënien e një përjashtimi ndaj aplikimit korrekt të këtij ligji, për funksionimin e duhur të tregut të brendshëm të gazit natyror.

3. Shoqëria e gazit natyror, për të cilën nuk është miratuar përjashtimi, sipas pikës 1 të këtij

neni, nuk mund ta refuzojë hyrjen në sistem, për shkak të angazhimeve “*take-or-pay*”, të pranuar në një kontratë blerjeje gaze natyror.

4. Çdo përjashtim, i miratuar nga ERE-ja sipas këtij neni, publikohet dhe arsyetohet siç duhet.

Neni 42

Alokimi i kapacitetit dhe menaxhimi i kufizimeve

1. Kapaciteti maksimal në të gjitha pikat përkatëse bëhet i disponueshëm për pjesëmarrësit e tregut, duke pasur parasysh integritetin e sistemit dhe operimin eficient të rrjetit. Për alokimin e kapacitetit, OST-ja zbaton mekanizma jodiskriminues, transparentë dhe të bazuar në treg, të miratuar nga ERE-ja, të cilët:

a) sigurojnë sinjalet e duhura ekonomike për përdorimin eficient dhe maksimal të kapacitetit teknik dhe mundësojnë investimet në infrastrukturën e re;

b) janë të pajtueshëm me mekanizmat e tregut dhe fleksibël për t’iu përshtatur ndryshimit të kushteve të tregut.

2. OST-ja informon ERE-në në përputhje me rregulloret e saj, kur kërkesa për kapacitet transmetimi në një pikë injektimi ose marrjeje krijon kufizime potenciale në atë pikë.

3. Kur OST-ja përfundon kontrata të reja për kapacitete transmetuese ose rinegocion kontratat ekzistuese, në hartimin e këtyre kontratave mbahen parasysh parimet e mëposhtme:

a) në rast të kufizimit kontraktual, kur niveli i kërkesës kalon kapacitetin teknik, OST-ja ofron kapacitetet e kontraktuara, të papërdorura në tregun primar, të paktën një ditë më përpara;

b) përdoruesit e sistemit, nëse dëshirojnë, mund ta rishesin në një treg sekondar, për të gjithë kohën ose përkohësisht, kapacitetin e kontraktuar prej tyre.

4. OST-ja përgatit dhe publikon informacion historik dhe parashikime të flukseve në çdo pikë injektimi dhe marrjeje, për çdo periudhë kohe të kërkuar nga ERE-ja.

5. ERE-ja miraton vënien e një pagese transparente dhe jodiskriminuese, si pjesë e tarifave të transmetimit e të tranzitimit, për të përmirësuar kufizimet në pikat e identifikuar të injektimit dhe të marrjes.

Neni 43

Operatori i kombinuar

1. Dispozitat e neneve 21 pika 2 dhe 27 pika 2 nuk përjashtojnë operimin e kombinuar të sistemeve të transmetimit dhe të shpërndarjes, instalimeve të GNL-së dhe të hapësirave të depozitimit nga një operator i vetëm, i cili duhet të jetë i pavarur nga pikëpamja ligjore, organizative dhe e vendimmarrjes, nga veprimtaritë e tjera, që nuk lidhen me operimin e sistemeve të transmetimit dhe shpërndarjes, instalimeve të GNL-së dhe hapësirave të depozitimit.

2. Personi përgjegjës për menaxhimin e operatorit të sistemit të kombinuar nuk përfshihet në strukturat e shoqërisë së integruar të gazit natyror, përgjegjëse drejtpërdrejt ose tërthorazi për operimin e përditshëm të prodhimit dhe furnizimit me gaz natyror.

3. ERE-ja sigurohet se operatorit të sistemit të kombinuar ka aftësitë teknike dhe menaxhuese për të operuar në mënyrë të pavarur.

4. Operatori i kombinuar mban llogari të ndara për çdo veprimtari, sipas nenit 15 të këtij ligji, si dhe pajiset nga ERE-ja me licenca të veçanta për çdo veprimtari, që kryen në sektorin e gazit natyror.

5. Operatori i sistemit të kombinuar përgatit një program, ku përcakton masat për monitorimin e tij dhe për të siguruar shmangien e sjelljes diskriminuese.

Neni 44

Linja direkte

1. Shoqëritë e gazit natyror, të krijuara brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, mund

të zgjedhin të furnizojnë klientët e kualifikuar nëpërmjet një linje direkte.

2. Ndërtimi i një linje direkte nga shoqëritë e gazit natyror ose klientët e kualifikuar bëhet vetëm me miratimin e Këshillit të Ministrave.

KREU V DETYRIMET E SHËRBIMIT PUBLIK

Neni 45

Detyrimet e shërbimit publik

1. Veprimtaritë e transmetimit, të shpërndarjes dhe të furnizimit me gaz natyror të klientëve tariforë realizohen si shërbime publike.

2. ERE-ja vendos ndaj të licencuarve në sektorin e gazit natyror detyrime të shërbimit publik, që kanë lidhje me:

- a) sigurinë e furnizimit;
- b) cilësinë dhe tarifat e furnizimit;
- c) përdorimin e burimeve vendase të gazit natyror;
- ç) efikasitetin e energjisë;
- d) mbrojtjen e mjedisit dhe ndryshimet klimaterike;
- dh) mbrojtjen e shëndetit, jetës dhe pronës së njerëzve.

3. Detyrimet e shërbimit publik duhet të jenë të përcaktuara qartë, jodiskriminuese, transparente dhe lehtësisht të verifikueshme.

Neni 46

Furnizuesi i alternativës së fundit

ERE-ja mund të përcaktojë një furnizues të alternativës së fundit për klientët e lidhur në rrjetin e gazit, të ndryshëm nga OSSH-ja, siç parashikohet në pikën 4 të nenit 36 të këtij ligji.

Neni 47

Detyrimi për të shërbyer

Pasi një klient tarifor bëhet i kualifikuar, OSSH-ja vazhdon t'i shërbejë këtij klienti derisa ai të zgjedhë një furnizues alternativ.

KREU VI MBROJTJA E KONSUMATORIT DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 48

Kushtet e përgjithshme të furnizimit

ERE-ja miraton kushtet e përgjithshme të furnizimit të klientëve tariforë, duke garantuar që:

- a) u është dhënë e drejta e një kontrate me siguresit e shërbimit të gazit, e cila specifikon:
 - i) identitetin dhe adresën e furnizuesit;
 - ii) shërbimet dhe nivelet e cilësisë së shërbimeve të ofruara, si dhe kohën për fillimin e lidhjes;
 - iii) tipat e shërbimit të mirëmbajtjes së ofruar, nëse ofrohet;
 - iv) mënyrat se si mund të merret informacioni i përditësuar mbi të gjitha tarifat dhe pagesat e mirëmbajtjes;
 - v) kohëzgjatjen e kontratës, kushtet për rinovimin dhe përfundimin e shërbimeve e të kontratës, mundësinë e ndonjë të drejte për t'u tërhequr;

vi) çdo kompensim që zbatohet, nëse nuk plotësohen nivelet e shërbimit të kontraktuar;
vii) mënyrën për fillimin e procedurave për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, në përputhje me nenin 49 të këtij ligji;

b) u është dhënë njoftimi i duhur për çdo synim, për të modifikuar kushtet kontraktuale. Furnizuesit njoftojnë drejtpërdrejt klientët e tyre për çdo rritje të tarifave, jo më vonë sesa një periudhë normale e faturimit, përpara se rritja të bëhet efektive;

c) kanë marrë informacion transparent për çmimet, tarifat, termat dhe kushtet standarde, veçanërisht për hyrjen në rrjet dhe përdorimin e shërbimeve të gazit natyror;

ç) do të përfitojnë nga procedurat transparente, të thjeshta dhe jo të shtrenjta, për të trajtuar ankesat e tyre. Këto procedura do të mundësojnë që mosmarrëveshjet të zgjidhen drejt dhe menjëherë, me dhënien, kur kërkohet, të një rimbursimi dhe/ose kompensimi;

d) janë të informuar rreth të drejtave të tyre për t'u furnizuar, sipas këtij ligji, me gaz natyror, me një cilësi shërbimi të caktuar dhe me tarifat e publikuara.

Neni 49

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. ERE-ja zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet të licencuarve në sektorin e gazit natyror, si dhe ndërmjet tyre e klientëve.

2. ERE-ja nxjerr rregulla të veçanta për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, sipas pikës 1 të këtij neni.

3. Vendimi i ERE-së për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje është i detyrueshëm për palët deri në marrjen e një vendimi pezullimi ose të formës së prerë të një gjykate kompetente.

4. Për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, ERE-ja mund të angazhojë ekspertë të fushës përkatëse.

5. ERE-ja mund t'u kërkojë të licencuarve të zhvillojnë mekanizma të brendshëm, për të trajtuar zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

6. Për ankesat e palëve të interesuara ndaj një të licencuari, që kanë të bëjnë me hyrjen në sistem ose në hapësirat e depozitimit, ERE-ja merr një vendim, brenda dy muajve pas marrjes së ankesës. Kjo periudhë dymujore mund të zgjatet edhe me dy muaj të tjerë, kur nga ERE-ja kërkohet informacion shtesë ose kur ankimesi bie dakord.

KREU VII

TË DREJTAT E PRONËSISË

Neni 50

Të drejtat e pronësisë së të licencuarve

1. Për kryerjen e veprimtarive në sektorin e gazit natyror, për të cilat është licencuar, i licencuari, në përputhje me dispozitat e Kodit Civil dhe dispozitat e ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, mund të kërkojë ndaj të tretëve zbatimin e njëres prej të drejtave të mëposhtme:

a) të drejtën e servitudit;

b) të drejtën e marrjes në përdorim të përkohshëm të pronës;

c) shpronësimin.

2. Të tretët, që preken nga zbatimi i njëres prej dispozitave të pikës 1 të këtij neni, rimbursohen nga i licencuari, sipas Kodit Civil, titulli VI, kreu II dhe sipas neneve 23 e 27-37 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”.

KREU VIII
KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE DHE SANKSIONET

Neni 51
Kundërvajtjet administrative

1. Kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative:
 - a) çdo shkelje e rregullave të sigurimit teknik, të vendosura nga Këshilli i Ministrave, sipas pikës 1 të nenit 7 të këtij ligji, e cila dënohet nga Inspektorati Qendror Teknik me sanksionet e parashikuara në legjislacionin në fuqi;
 - b) kryerja e një veprimtarie në sektorin e gazit natyror pa licencën përkatëse, të lëshuar nga ERE-ja, e cila dënohet me gjobë, të vendosur nga ERE-ja, në vlerën 300 000 - 500 000 lekë.
2. Kundërvajtjet e mëposhtme:
 - a) mosdërgimi në afat nga të licencuarit të raportit ekonomiko-financiar dhe të çdo informacioni të kërkuar nga ERE-ja;
 - b) mosshlyerja e detyrimeve financiare ndaj ERE-së në afatet kohore të përcaktuara;
 - c) moszbatimi i vendimeve të ERE-së për tarifat;ç) çdo shkelje e kushteve të përcaktuara në licencë;
ndëshkohen sipas dispozitave të nenit 64 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.
3. Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative, ankimi dhe ekzekutimi i vendimeve bëhen sipas Kodit të Procedurave Administrative dhe të ligjit nr.7697, datë 7.4.1993 “Për kundërvajtjet administrative”, të ndryshuar.

KREU IX
DISPOZITA TRANZITORE DHE TË FUNDIT

Neni 52
Ndryshime të dispozitave të ligjeve të tjera

1. Në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:
 - a) emërtimi “Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike” (ERE) zëvendësohet me emërtimin “Enti Rregullator i Energjisë” (ERE);
 - b) pika 7 e nenit 4 ndryshohet si më poshtë:
“7. Kryetari dhe anëtarët e bordit duhet të jenë me arsim të lartë dhe me përvojë:
 - a) Kryetari të jetë një personalitet në fushën e energjisë dhe të ketë jo më pak se 15 vjet përvojë pune, prej të cilave jo më pak se 10 vjet në sektorin e energjisë;
 - b) Njëri nga anëtarët duhet të ketë jo më pak se 10 vjet përvojë pune në sektorin e energjisë elektrike;
 - c) Një tjetër anëtar duhet të ketë jo më pak se 10 vjet përvojë pune në sektorin e hidrokarbureve;
 - ç) Dy anëtarët e tjerë duhet të kenë jo më pak se 7 vjet përvojë pune në administratën publike, në sistemin e drejtësisë dhe në sistemin bankar ose atë financiar.”.
2. Në ligjin nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, të gjitha shprehjet “për sektorin e gazit natyror” shfuqizohen.

Neni 53

Mandati i anëtarëve të bordit të ERE-së

Anëtarët e bordit të komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike, të emëruar nga Kuvendi përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që nuk e kanë përfunduar mandatin e tyre, të vazhdojnë detyrën deri në përfundim të tij.

Neni 54

Trajtimi i lejeve dhe kërkesave ekzistuese për ndërtimin e gazsjellësve dhe të instalimeve të tjera të infrastrukturës së gazit

1. Lejet e koncesionit për ndërtimin dhe përdorimin e gazsjellësve dhe të instalimeve të tjera të infrastrukturës së gazit, të dhëna nga Këshilli i Ministrave, sipas dispozitave të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, edhe pas hyrjes në fuqi të këtij ligji janë të vlefshme deri në afatin, për të cilin janë dhënë.

2. Personat e pajisur me leje koncesioni për ndërtimin dhe përdorimin e gazsjellësve dhe të instalimeve të tjera të infrastrukturës së gazit, sikurse përcaktohet në pikën 1 të këtij neni, pajisen nga ERE-ja me licencën përkatëse për kryerjen e një ose më shumë veprimtarive në sektorin e gazit natyror, sipas dispozitave të këtij ligji.

3. Të gjitha kërkesat për leje koncesioni për ndërtim dhe përdorim gazsjellësi dhe të instalimeve të tjera të infrastrukturës së gazit, që janë paraqitur nga personat e interesuar, përpara datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe janë në proces shqyrtimi, trajtohen sipas dispozitave të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar dhe të akteve të tjera nënligjore në fuqi.

Neni 55

Aktet nënligjore

Ngarkohen Këshilli i Ministrave, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Enti Rregullator i Energjisë të nxjerrin aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 56

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5809, datë 10.7.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 21.7.2008
Doli nga shtypi më 22.7.2008

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Ilar”
Tiranë, 2008

Çmimi 36 lekë